# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-469232**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Rama në New York: Shqipëria ka ndërtuar imunitetin ndaj korrupsionit, dikur nuk luftohej - Euronews Albania |
| ADRESA | `https://euronews.al/rama-ne-new-york-shqiperia-ka-ndertuar-imunitetin-ndaj-korrupsionit-dikur-nuk-luftohej/` |
| BURIMI | euronews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 14:38:14 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 14:34:41 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `08478a621ff84dcfe06bddae9194bc8e437c808fb609c2ff5a96dbc0b6750b67` |
| TEKSTI | `36166841cc934b3840fc2cecffa5e9c40f9efc300a74f3134f715b35c1f0a46a` |
| PAMJA | `e0f7e762b54eeabf732e1f82c1986667f37b0c7692a60a863d6ada63ae143b89` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `d08d9e64e2f5fe82697f831478b388efa14ef14e9fd54e06f19f5800fdff1dfb` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/d08d9e64e2f5fe82697f831478b388efa14ef14e9fd54e06f19f5800fdff1dfb`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKË | VENDI

# Rama në New York: Shqipëria ka ndërtuar imunitetin ndaj korrupsionit, dikur nuk luftohej

25 Shtator 2026 | 16:34

SHPËRNDAJE ARTIKULLIN

Kryeministri Edi Rama deklaroi nga Nju Jorku se Shqipëria ka pësuar një transformim të thellë gjatë viteve të fundit, duke veçuar rritjen ekonomike, zhvillimin e infrastrukturës dhe forcimin e institucioneve në luftën kundër korrupsionit.

Gjatë fjalës së mbajtur në mbrëmjen gala të Këshillit të Marrëdhënieve Shqiptaro-Amerikane, Rama tha se vendi ka arritur rezultate që, sipas tij, jo të gjithë i pranojnë lehtë.

“Sa shumë ka ndryshuar Shqipëria gjatë këtyre viteve. Askush nuk ta fal suksesin. Po, është viti i pestë a i gjashtë që kemi aeroportin më të madh në rajon. Duke qenë shumë i madh jo vetëm në terma relative, që është aeroporti me rritjen më të madhe në Europë, por edhe me shifra absolute, me shumë udhëtarë se aeroporti i Beogradit. Do të vazhdojë sepse është vetëm fillimi,” u shpreh Rama.

Kreu i qeverisë u ndal edhe te perceptimi për korrupsionin në vend, duke argumentuar se partnerët europianë e vlerësojnë si sukses faktin që institucionet po veprojnë çdo ditë kundër tij.

“Ne shqiptarët, ajo që ne e shohim si problem, partnerët europianë e shohin si sukses. Pyetja është: a mund të ketë një vend më shumë korrupsion nëse ai luftohet çdo ditë? Dikur në Shqipëri, korrupsioni ishte gjithkund dhe lufta askund. Sot shohim diçka ndryshe. E shohim sepse sistemi demokratik i Shqipërisë ka nisur të ndërtojë imunitetin e vet,” tha ai.

Sipas Ramës, funksionimi i pushteteve të pavarura, pavarësisht sfidave dhe mangësive, tregon se korrupsioni nuk mbetet më pa pasoja.

Në fjalën e tij, kryeministri solli si shembull edhe ndryshimet në mbrojtjen e mjedisit, duke kujtuar ndalimin e gjuetisë dhe zgjerimin e zonave të mbrojtura.

“Ky është sukses i madh për një vend ku 10 vjet më parë, kafshët dhe shpendët masakroheshin nga mijëra gjuetarë europianë. Sot vendi proteston për biodiversitetin. Pasi ndaluam gjuetinë, rritëm zonat e mbrojtura dhe ndaluam shfrytëzimin e pyjeve, rritëm trefish numrin e shpendëve dhe kafshëve, si dhe sipërfaqen e pyjeve të rikuperuara,” u shpreh ai.

Në përmbyllje, Rama tha se pritshmëritë e qytetarëve ndaj vendit kanë ndryshuar.

LAJMI I FUNDIT

16:29 Aksident në aksin Lezhë-Shkodër, furgoni me mësues përplaset me një taksi! Tre të plagosur (VIDEO)

16:28 Rama deklaratë të fortë nga New York: Joe Biden tradhëtoi Hashim Thaçin “Xhorxh Washingtonin e Prishtinës”

16:24 Ministri i Jashtëm polak paralajmëron: Rusia mund të jetë duke përgatitur “diçka të madhe” këtë vit

16:24 Autori akuzohet për përdorim të IA-së, çmimi prestigjioz francez “Goncourt” heq nga lista romanin

16:22 Vunoi shpallet zyrtarisht “Qendër Historike”, qeveria miraton zonën e mbrojtur

16:20 Lëvizje të reja në qeveri, dalin vendimet pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave

TESTIM

"Tashmë kemi një Shqipëri të re. Njerëzit duan më shumë. Shqipëria ku njerëzit jetonin me idenë se vendi mund të jetë më keq nuk ekziston më," përfundoi kryeministri.

**Shiko në:**

## LAJME TË SUGJERUARA

LAJM KRYESOR | POLITIKË | VENDI

### Rama deklaratë të fortë nga New York: Joe Biden tradhëtoi Hashim Thaçin "Xhorxh Washingtonin e Prishtinës"

Kryeministri Edi Rama ka deklaruar nga Nju Jorku se Shtetet e Bashkuara mund të kishin bërë më shumë për të mos lejuar, sipas tij, nisjen...

16:28 | 25/09/2026

POLITIKË | VENDI

### Lëvizje të reja në qeveri, dalin vendimet pas mbledhjes së Këshillit të Ministrave

Këshilli i Ministrave ka miratuar këtë të premte një sërë ndryshimesh në drejtimin e institucioneve dhe në përbërjen e qeverisë. Oltjon Muzaka është liruar nga...

16:20 | 25/09/2026

AKTUALITET | POLITIKË | VENDI

### Grupi Parlamentar i PD depoziton ligjin për ndarjen territoriale të vendit: 100 bashki dhe 12 qarqe

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka depozituar zyrtarisht këtë të premte draftin ligjin për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri. Grupi Parlamentar...

15:41 | 25/09/2026



Copyright © Euronews 2026

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.